



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA GRAMSH**  
**NJËSIA E PROKURIMIT**

Nr \_\_\_\_\_ prot

Gramsh, më 21/05/2020

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT**

Data 21.05.2020

Për: BOE - "Gele Zani"sh.p.k & "Muca-2006"sh.p.k

Adresa: Fshati Cërunjë,ZK nr.1392,nr.pasurisë 19/5+1,Njësia Administrative Pishaj,Gramsh & Fshati Perondi,lagjia "Qendër",rruga kryesore godinë një katëshe ,ZK.nr.2179.nr.pasurisë 123,Berat.

Procedura e prokurimit: "Procedurë e hapur ",me mjete elektronike

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-54905-03-25-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: "Blerje mjetesh transporti e makineri për nevojat e bashkisë", me afat 30 ditë nga data e lidhjes së kontratës.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike 30/03/ 2020 [Nr. 17]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X**, oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

\* \* \*

1. **Shoqëria- "Elim Agron"sh.p.k** me nr.Nipti K81519014I me vlerë të ofertës 15 500 000(pesëmbëdhjetëmilionë e pesëqind mijë) lekë,pa TVSH.
2. **BOE - "Gele Zani"sh.p.k & "Muca-2006"sh.p.k** ,me nr.Nipti L87301801L & K77606101B me vlerë të ofertës 16 640 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e dyzetëmijë)lekë,pa TVSH.
3. **Shoqëria- "Lexalko " sh.p.k** me nr.Nipti L02222010A me vlerë të ofertës 16 100 000(gjashtëmbëdhjetëmilionë e njëqind mijë)lekë,pa TVSH.
4. **Shoqëria- "Power Industries " sh.p.k** me nr.Nipti L51706022H me vlerë të ofertës 16 470 000(gjashtëmbëdhjetë milionë e katërqind )lekë,pa TVSH.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm :

**1. Shoqëria- "Elim Agron"sh.p.k për arsyet :**

Nga ana e Komisionit te Vleresimit te Ofertave konstatohet se ky OE **nuk** ka dorëzuar ne SPE gjithë dokumentacionin lidhur me kualifikimin tekniko-ligjor te kerkuar ne Kriteret e Pergjithshme dhe te Vecanta te Kualifikimit te pershkruara ne DST,si më poshtë:

- Nuk ka dorëzuar vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik, në kundërshtim me nenin 27 pika 5/c të VKM-së nr. 914 dt.29.12.2014 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"i ndryshuar,si dhe pikën 1/e të Kritereve të Vecanta të Kualifikimit .
- Referuar listë pagesave të punonjësve të siguruar nuk plotëson numrin prej 5(pesë)

punonjësve të siguar për periudhën 3-muaj nga data e zhvillimit të tenderit , në kundërshtim me pikën 2.3.4 të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit.

- Nuk ka dorëzuar vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2019, ka dorëzuar mandate arkëtimet por nuk provon me anë të një vërtetimi që këto detyrime janë paguar të gjitha dhe që nuk ka detyrime të tjera për këto taksa, në kundërshtim me pikën 2.3.2 të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit.
- Nuk ka dorëzuar certifikatën ISO 9001-2015, në kundërshtim me pikën 2.3.3 të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit.
- Nuk ka dorëzuar dokumentacion që të disponojë ose të paraqesi kontratë bashkëpunimi me servis të specializuar për riparimin e mjeteve të transportit brenda afatit të garancisë. Për të vërtetuar këtë pikë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë edhe foto të ambienteve të brendshme të reparteve të punës, në kundërshtim me pikën 2.3.8 të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit.
- Bilancet e dorëzuara nuk janë të konfirmuara nga Drejtoria Rajonale Tatimore , në kundërshtim me pikën 2.2.a, të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit.
- Nuk ka dorëzuar deklaratë garancie për mallrat e ofruar, në të cilën të jenë përcaktuar dhe përshkruar qartë të gjithë termat dhe kushtet e garancisë teknike që mbulon ofertuesi, si dhe periudha e garancisë teknike jo më pak se 1 (një) vit nga marrja në dorëzim e mallit, objekt prokurimi, në kundërshtim me pikën 2.3.6, të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit.
- Nuk ka dorëzuar kontratë pune me një inxhinier mekanik ,staf teknik i paisur me deshmi aftesi profesionale leshuar nga Ministria Transportit ose ekuivalente për të cilin duhet të paraqitet kontrata e punës, në kundërshtim me pikën 2.3.7, të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit
- Nuk ka dorëzuar një deklaratë me anë të së cilës të deklarojë se në momentin e dorëzimit të mjeteve do t'i shoqërojë ato dokumentacionin e kërkuar sipas pikës 2.3.8, të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit.

## **2. Shoqëria- “Lexalko” sh.p.k për arsyet :**

Nga ana e Komisionit te Vleresimit te Ofertave konstatohet se ky OE **nuk** ka dorezuar ne SPE asnjë nga dokumentat lidhur me kualifikimin tekniko-ligjor te kerkuar ne Kriteret e Pergjithshme dhe te Vecanta te Kualifikimit te pershkruara ne DST,si më poshtë:

- Nuk ka dorëzuar asnjë dokument lidhur me kualifikimin tekniko-ligjor.Ka dorëzuar vetëm formularin e ofertës,pa nënshkrim dhe pa vulë.

## **3. Shoqëria- “Power Industries” sh.p.k për arsyet :**

Nga ana e Komisionit te Vleresimit te Ofertave konstatohet se ky OE **nuk** ka dorezuar ne SPE gjithë dokumentat lidhur me kualifikimin tekniko-ligjor te kerkuar ne Kriteret e Pergjithshme dhe te Vecanta te Kualifikimit te pershkruara ne DST,si më poshtë:

- Në kriteret e vecanta të kualifikimit është përcaktuar se :”*Operatori Ekonomik duhet të disponoj ose të paraqesi kontratë bashkëpunimi me servis të specializuar për riparimin e mjeteve të transportit brenda afatit të garancisë. Për të vërtetuar këtë pikë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë edhe foto të ambienteve të brendshme të reparteve të punës*”. Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik “Poëer Industries” shpk , ka dorëzuar kontratën e qirasë nr.609 Rep,nr.201 Kol datë 08.02.2018,bashkëngjitur dhe dokumentat e pronësisë së qiradhënësit.

Nga verifikimet e kryera nga komisioni u konstatua se i njëjti objekt,me të njëjtën nr.pasurie i është dhënë me qira një subjekti tjetër nëpërmjet kontratës nr,6703 Rep.nr.165 Kol datë 06.11.2019 , fakt ky që e bën të shfuqizohet kontrata e parë.Nga verifikimi në vend i kryer nga komisioni u konstatua se ky objekt aktualisht përdoret për

shitje me pakicë e shumicë e artikujve industrialë , ushqimore, detergjentë ,etj,për të cilat nga ana e komisionit janë bërë dhe fotot përkatëse. Referuar legjislacionit të prokurimit publik në fuqi dhe akteve nënligjore e udhëzimeve të APP-së të dala në zbatim të tij , në rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.Operatori ekonomik, mban përgjegjësi për të gjithë dokumentacionin e paraqitur si pjesë e ofertës. Në rast verifikimi të përmbajtjes së dokumentacionit të paraqitur, apo të vetëdeklarimeve, kur përmbajtja e tyre nuk rezulton e vërtetë, operatori ekonomik ndodhet në kushtet e parashikuara në nenin 13, pika 3, gërma (a) të LPP-së.Verifikimi u krye në date 12.05.2020.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, **informojmë -BOE - “Gele Zani”sh.p.k & “Muca-2006”sh.p.k**, me adresë Fshati Cërunjë,ZK nr.1392,nr.pasurisë 19/5+1,Njësia Administrative Pishaj,Gamsh & Fshati Perondi,lagjia “Qendër”,rruga kryesore godinë një katëshe ,ZK.nr.2179.nr.pasurisë 123,Berat, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 16 640 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e dyzetëmijë)lekë,pa TVSH, pikët totale të marra [\_\_\_\_],është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Bashkisë Gramsh**, Bulevardi “10 korriku”,Sheshi “Kamber Dërmyshi “ ,pranë Njesisë së Prokurimit,kati tretë, kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [\_\_\_\_], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 13.05.2020.

**Ankesa:** Nuk ka pasur ankesa .

## **TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**KRYETARI  
KLODIAN TAÇE**

Konceptoi: E.Guzi

Miratoi: E.Guzi

Dosja nr: \_\_\_\_\_

Afati i ruajtjes: \_\_\_\_\_